



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 08.08.2017 Ref.: 653117

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.541/17, datë 22.07.2017 e BPrAL Kolegji ISPE për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.581/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 581/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji ISPE me 26.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 581/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim BPrAL Kolegjit ISPE i është pezulluar akreditimi për këto programe të studimit: Ekonomik, BA, 180 ECTS; Juridik, LLB, 240 ECTS; Shkenca Politike, BA, 180 ECTS; Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, dhe Studime të Sigurisë, MA, 120 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji ISPE, është konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë argument i cili do të mund të merrej në konsideratë nga KSHC. Kolegji ISPE bashkë me kërkesën për rishqyrtim të vendimit për pezullim të akreditimit ka dorëzuar edhe një listë (një faqe) me emrat e stafit akademik si bartës të programeve (40 emra) nga të cilët sipas kësaj liste, ndër të tjera, 20 janë pa nostrifikim të diplomës dhe 10 nga ta nuk kanë leje qëndrim të Republikës së Kosovës. Kjo listë konfirmon gjendjen faktike të institucionit në bazë të së cilës KSHC ka marr vendim për pezullim.

Pezullimi i akreditimit për programet e cekura më sipër, është bërë pasi është konstatuar që asnjëri nga programet e cekura më sipër nuk i plotëson kushtet minimale me stafin akademik e që sipas nenit 11, pika 3.2 e UA për Akreditim, për secilin program të studimit duhet të kenë të paktën tri staf akademik me marrëdhënie të rregullt të punës me gradën shkencore PhD (Dr.sc.)

Vendimi i KSHC-së për pezullim është në përputhje të plotë me nenin 28 , pika 2 dhe 3 UA për Akreditim (Nr.20/2016, datë 20.09.2016). Sipas nenit 28 , pika 2 dhe 3, AKA mund ta tërheq akreditimin në rastet e caktuara. Sipas këtij neni, AKA mund ta tërheq akreditimin në rast se ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve të studimit në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe, andaj bazuar në këtë çka u tha me sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më sipër, dhe asaj që u cek më sipër, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017 vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "ISPE";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

